Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1043

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "S.I.G." SH.P.K., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me numër të prokurimit KEK-23-4552-2-1-1, me 12/03/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "S.I.G." SH.P.K., me nr. 2023/1043, e datës 22/12/2023, kurse vendimi i AK "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1.

2. **Anulohet** njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – "Korporata Energjetike e Kosovës" sh.a, dhe lënda kthehet në **Rivlerësim.**

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 19.05.2023, “Korporata Energjetike e Kosovës” sh.a në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut” me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1. Ndërsa me datën 07.12.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE “Defence Secutity& International Security AHH SHPK.”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës **2,780,159.38 €.**

Me 11.12.2023, OE “S.I.G.” SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 14.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “S.I.G.” SH.P.K., me nr. 1043/23 për lidhur me aktivitetin “Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut” me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “S.I.G.” SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Të pa kënaqur me njoftimin mbi vendimin e AK-së "Korporata Energjetike Kosovës" të datës 07.12.2023 në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. KEK-23-4552-2-1-1 në afatin e lejuar ligjor konform Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik, ushtrojmë këtë “Ankesë”:

Për shkak se AK: Korporata Energjetike Kosovës - Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë për aktivitetin e prokurimit me të dhënat e lartcekura një OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e AK-së të vendosura në Njoftimin për kontratë dhe Dosjen e tenderit të përshkruara edhe rregullat përmbajtjesore në Aneksin 1 tek Specifikimet teknike të detyrueshme.

- Nuk ka zbatuar në përpikëri vendimin e OSHP-së me nr.593-597-594-23 të datës 16.11.2023 që gjatë procesit të ri-vlerësimit të ofertave të veproj në bazë të Nenit 59 dhe Nenit 72 të LPP-së.

Sqarojmë në mënyrë të detajuar: Me datën 19.05.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dosjen e tenderit në platformën e E-prokurimit, duke dhënë detaje të mjaftueshme tek Aneksi 1 - Specifikimet teknike të Detyrueshme ku obligohen të gjithë operatorët ekonomik që gjatë hartimit të Analizës Financiare në lidhje me çmimin, të respektohen në tërësi ligjet aktuale në lidhje me orarin e punës dhe rregullave të tjera të ndërlidhura me Ligjin e Punës, ndër të tjera ka cekur edhe shujtën për punëtorët. Këto kërkesa kanë qenë obligative për të gjithë OE-të.

Në anën tjetër me datën 07.12.2023 Autoriteti Kontraktues publikon njoftimin mbi vendimin e AK-së ku si rezultat e rekomandon për dhënie të kontratës OE "Defence Security & International Security AAH" Sh.p.k, pas ri-vlerësimit të ofertave, e që edhe kjo kompani nuk është e përgjegjshme në bazë të kërkesave të cekura nga ana e Autoritetit Kontraktues në dosjen e tenderit, pasi që pa-përgjegjshmërinë e këtij OE e keni edhe të filtruar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së sepse i njëjti çmimin për shujtën e punëtorëve.

Konstatimi i pestë (V): Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën e OE "Defence Security" SHPK sqaron se, OE ankuesi në ankesë ka bashkangjitur një dëshmi lidhur me analizën mirëpo tek shujta mendoj se ka ndërhyrje nga 2 euro OE ankues (ju) keni vendosur 1 euro, kurse sa i përket kalkulimit, në analizë shihet tek pika 4. Për festa 7500 euro, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta sqaroj analizën edhe njëherë, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht e bazuar.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillur këtë konstatim të PSH-së, pasi që gjatë Rivlerësimit nuk e ka bërë sqarimin e analizës së OE të rekomanduar për kontratë "Defence Security & International Security AAH".

Eliminimi i kompanisë sonë tendencioz dhe i gabuar: Edhe në vendimin paraprak të OSHP-së me nr.597-23 të datës 16.11.2023, Paneli Shqyrtues edhe në bazë të ekspertizës së kryer ka dhënë mbështetje në parregullsinë e AK-së kur ka bërë eliminimin e kompanisë sonë në lidhje me arsyetimin se nuk e përmbushim kërkesën me nr.3 lidhur me veturat patrulluese, edhe pse ne kemi dhënë dëshmi të mjaftueshme dhe kemi bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme.

Paneli Shqyrtues në vendimin e lëshuar e obligon AK-në që gjatë Rivlerësimit të ofertave të veproj në harmoni me Nenin 72 të LPP-së dhe duhet të veproj në bazë të konstatimeve të tyre, gjë që gjatë këtij procesi AK-ja nuk ka kërkuar asnjë sqarim në lidhje me ofertën tonë përkatësisht në lidhje me veturat patrulluese gjë që arsyetimi i tyre për eliminim nuk është i bazuar sepse marrëveshjet e lidhura me kompanitë që veturat mund ti shfrytëzojmë edhe ne si kompani për këtë aktivitet të prokurimit dhe se askund nuk ceket se një gjë e tillë nuk mund të ndodh, mirëpo e kundërta e arsyes së eliminimit gjendet në marrëveshjet e dorëzuara ku një gjë e tillë nga lejohet nga kompania me të cilën kemi marrëveshje.

Qasja në dokumentet publike na është lejuar mirëpo pjesërisht pasi që dokumentet e klasifikuara si sekret afarist nga ana e OE të rekomanduar për kontratë nuk na është lejuar e që AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Nenit 7 (trajtim të barabartë dhe jo diskriminues), Nenit 10 (mjetet për promovimin e transparencës) dhe Nenit 11 (informatat sekrete afariste) të LPP-së, sepse AK nuk na ofruar versionin e pastruar të dokumenteve të cilat OE i ka klasifikuar si sekret afarist, gjë që na ka pamundësuar të vërejmë nëse OE i rekomanduar për kontratë i posedon të gjitha dokumentet e tjera të kërkuara sipas dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Operatori i rekomanduar për kontratë sqarojmë se nëse bazohemi në obligimin e juaj për zbatimin e Ligjit të Punës dhe rregullave të tjera të ndërlidhura me to si dhe legjislacionin sekondar si: udhëzimet administrative të MPMS-së në lidhje me orët e punës, vendimet e Qeverisë në lidhje me pagat minimale konsiderojmë se ky Operator ekonomik nuk është dashur të rekomandohet për kontratë pasi që me çmimin e ofertuar nuk mund të zbaton në asnjë rrethanë as punën obligative të një punëtori prej 176 orë pune e as të paguaj paga e kontribute pensionale pranë organeve shtetërore, e me çmimin manipulativ nuk do të arrij të paguaj as shtesat e tjera (punën gjatë natës, vikendeve, festave) e as të ju mundësoj punonjësve pushimin vjetor me

pagesë, pasi që me këtë çmim pos që do të dëmtohen punëtorët do të dëmtohet edhe buxheti i shtetit sepse nuk do të mund të zbatohet kontrata sipas kushteve të vendosura nga ana juaj në dosjen e tenderit (aneks 1 - specifikimet teknike të detyrueshme).

Ju si Autoritet Kontraktues po bëni edhe shkeljen e të drejtave të punëtorëve pasi që të njëjtët po nënvlerësohen si dhe po cilësohen si kategoria më e ulët me paga të ulëta, ju duhet të keni deratë të ju jepen paga dinjitozë e jo të rekomandohen operator ekonomik që as për së afërmi nuk mund të ju japin paga të mira e që kjo po ndikon dukshëm më pastaj në përformancën dhe vigjilencën e tyre gjatë punës, kështu operatori ekonomik nuk do të mund të ofroj shërbime cilësore e profesionale.

Poashtu si Autoritet Kontraktues po bien në kundërshtim me dispozitat ligjore të Nenit 17.31 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik ku thuhet: "Ofertat nga ofertuesit të cilët nuk kanë marrë parasysh obligimet e dispozitave të mbrojtjes së punëtoreve dhe kushteve të punës të identifikuara nga autoriteti kontraktues në dokumentet e kontratës nuk mund të konsiderohen si në përputhje me dokumentet e kontratës. Për më tepër, kur ofertuesit nuk marrin parasysh në mënyre të mjaftueshme këto detyrime në tenderët e tyre, tenderët e tyre mund të konsiderohen si jo-normalisht të ulët dhe mund të refuzohen për këtë arsye"

Poashtu Neni 17.32 të Rregullores Nr.001/2022 po thuhet: "Në rast se çmimi i ofruar nga Ofertuesi nuk mbulon pagat minimale të punonjësve që do të përfshihen në ekzekutimin e kontratës, e rregulluar nga Ministritë në sektorë të ndryshëm, oferta mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët. Gjatë përcaktimit të pagave minimale dhe pagave që do tu paguhen të punësuarve, Autoritetet Kontraktuese dhe Ofertuesit duhet të respektojnë pagat minimale të kërkuara dhe taksat dhe kontributet sociale përkatëse të publikuara në sektorët përkatës. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë informacion lidhur me pagat minimale përkatëse të zbatueshme nga ana e Operatorit ekonomik gjatë vlerësimit të arsyetimeve të dorëzuara nga Operatorët ekonomik".

Andaj duke marr parasysh këto dispozita ligjore Autoriteti Kontraktues nuk ka zbatuar në përpikmëri dispozitat ligjore të Nenit 7 të LPP-së pasi që nuk na ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë ofertuesve, dhe ka përdorur standarde të dyfishta me rastin e vlerësimit të ofertave, andaj konsiderojmë se nuk ka vepruar konform Nenit 59.4 të LPP-së, me çrast kërkesat obligative në dosjen e tenderit nuk përfillen nga vetë Autoriteti Kontraktues duke e rekomanduar për kontratë një Operator ekonomik i cili as për së afërmi nuk mund të mbuloj kërkesat e dosjes së tenderit.

Kurse me çmimin e ofertuar OE i rekomanduar nuk mund të mbulohen të gjitha këto shpenzime as për së afërmi e lëre të bëhet zbatimi i tyre e sidomos tek shujtat me çmimin e ofertuar.

Neni 56 i Ligjit Nr.03/L-212 i Punës parasheh pagesat shtesë prej 30% dhe 50% për orët gjatë natës, vikendeve dhe festave, ku edhe në Analizën financiare të kësaj kompanie se nuk janë zbatuar këto dispozita, dhe nuk i ka përfshirë OE i rekomanduar për kontratë.

Tek analiza financiare e ofruar nga ana e operatorit të rekomanduar për kontratë mund të shihet se "Kontributi pensional" , "Tatimi i mbajtur në burim" dhe "Pagesat shtesë për orët gjatë natës, festave dhe vikendit", "Shujtat" nuk janë të përfshira në Analizën financiare konform dosjes së tenderit, këto janë të parapara edhe në Nenin 56 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212.

Pas qasjes në dokumente publike të këtij operatori të rekomanduar për kontratë kemi vërejtur se i njëjti pos në aspektin financiar del të jetë i papërgjegjshëm edhe në aspektin administrativ.

Autoriteti Kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë Nenin 7 të LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi) ku Qëllimi i këtij neni është që Autoriteti Kontraktues t'i trajtoj në mënyrë të barabartë operatorët ekonomik dhe jo në mënyrë diskriminuese dhe poashtu të veproj në mënyrë transparente.

Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta pasi që gjatë vlerësimit të ofertave dhe analizave financiare të kërkuara, në njërën anë obligon Operatorët Ekonomik që të respektohen dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe rregullave të tjera, në anën tjetër edhe pse në Analizën financiare del se nuk janë respektuar këto dispozita ligjore në kuadër të Ligjit të Punës (pra nuk janë të përfshira të gjitha elementet), e konsideron ofertën e operatorit të rekomanduar për kontratë si të rregullt.

Andaj bazuar në të gjitha të gjeturat dhe të cekurat më lartë konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues aktivitetin e prokurimit Vlerësimin, krahasimin dhe Ekzaminimin e tenderëve nuk e ka bërë konform Nenit 59.4 të LPP-së, me ç 'rast nuk ka respektuar edhe kërkesën-kriterin kryesor e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas Nenit 60 të LPP-së.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "S.I.G." SH.P.K., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin Neni 1 Neni 1, 7 , 28, 59, 61, 69 të LPP-së si dhe Dispozitat e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik që supozohet të jenë shkelur: Neni 17, 27 dhe nenin 40. Duke propozuar që tëaprovohet si e bazuar ankesa e jonë të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. KEK-23-4552-2-1-1 e inicuar nga "Korporata Energjetike e Kosovës", dhe lënda të kthehet në rivlerësim, dhe pas Rivlerësimit të ofertave të shpërblej kompaninë e cila është e vetmja ofertë e përgjegjshme me çmimin më të ulët.

Përgjigje e AK ne kërkesën për rishqyrtim: "Pretendimet ankimore janë të pa bazuara pasi qe: Autoriteti Kontraktues KEK sh.a ka vlerësuar, shqyrtuar dhe krahasuar ofertat konform kërkesave të dosjes se tenderi .

1 .Pretendimi juaj se AK është dashtë te kërkoj sqarime ne lidhje me shfytyrimin e automjeteve është i pa bazuar pasi që siç e kemi ceke edhe ne letrën standarde për eliminim AK nuk ka mund të kërkoj sqarime pasi që për AK ka qene e qartë dhe po ju sqarojmë dhe njëherë se: Automjetet janë në pronësi të kompanive RENT MARA dhe RENT ELRONI me të cilat ju nuk keni marrëveshje direkte për marrjen me qira të automjeteve dhe te cilat nuk janë në pronësi tuajën. Automjetet janë në pronësi të kompanive RENT MARA dhe RENT ELRONI me të cilat ju nuk keni marrëveshje direkte për marrjen me qira të automjeteve. Ju në ofertë keni prezantuar një marrëveshje me kompaninë JAGUAR SECURITY SH.P.K e cila pastaj ka një marrëveshje për marrjen e automjeteve me qera nga kompanitë RENT MARA dhe RENT ELRONI.Në marrëveshjen në mes të JAGUAR SECURITY SH.P.K dhe dy kompanive për dhënie me qera të automjeteve ceket se JAGUAR SECURITY SH.P.K mundë ti shfrytëzoj automjetet për nevojat e saj por nuk ceket se mund ti jap në shfrytëzim kompanive tjera si në rastin në fjalë.Njeherit JAGUAR SECURITY SH.P.K nuk është pjese e grupit të konzorciumit me ju.

2.Pretendimi i juaj se OE i rekomanduar për kontratë nuk i mbulon kostot është i pa bazuar pasi që ne bazë analizës të pranuar nga OE i rekomanduar pas kërkesës për sqarim nga AK gjatë fazës

së vlerësimit të këtij aktiviteti shihet se OE i rekomanduar për kontratë i ka përfshi të gjitha kostot sipas kërkesës se AK e cila ka qene kërkesë për kostot që ne dosjen e tenderit kosto e tyre ka qene e fiksuar dhe OE ne analizën e dorëzuar shihet se kostot ne fjalë i mbuluara andaj AK ka propozuar të shpërblehet OE i përgjegjshëm me çmimin me te ulet.Njëherit nga vendimi i OSHP vërehet një detaj që ju keni ndërhyre ne analizën e OE të rekomanduar duke ja ndrysh çmimin e shujtës nga 2 Euro ne 1 Euro.Ju sqarojmë se OE i rekomanduar për kontratë e ka theksuar dhe sqaruar qartë se shujta është 2 euro konform kërkesë se dosjes se tenderit (të bashkangjitur me poshtë gjeni dëshminë).

3.Ndersa sa i përket pretendimit tuaj se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka kalkuluar festat është i pa bazuar pasi qe ne përgjigjen./analizën e OE të rekomanduar është sqaruar edhe kostoja e ditëve festive ne vlerë 7,500 Euro (me poshtë të bashkangjitur me poshtë gjeni dëshminë.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 27.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1043/23, ndërsa me datë 05.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2023/1043 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk Pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertin shqyrtuese, ndërsa OE është Pajtuar me mendimin e ekspertit .

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "S.I.G." SH.P.K.,- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/1043 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigje ne pretendimet ankimore të OE ankues: "Aktiviteti i prokurimit: "Sigurimi fizik i objekteve te KEK-ut" me nr. të prokurimit: "KEK-23-4552-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 19.05.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 12.06.2023, njoftimi B58-rivlerësim publikohet me datë 07.12.2023.

OE i rekomanduar për kontratë është "Defence Security & International Security AAH Shpk.. ndërsa OE ankuesi është shpallur i eliminuar me arsyetimin: "Arsyetim: tenderi juaj është refuzuar për ketë arsyeje: Keni, prezantuar automjete të cilat nuk janë ne pronësinë tuaj Automjetet janë ne pronësi të kompanive RENTA MARA dhe RENT EURONI me të cilat ju

nuk keni marrëveshje direkte për marrjen me qira të automjeteve, Ju ne ofert keni prezantuar një marrëveshje me kompaninë JAGUAR SECURITY SHPK. e cila pastaj ka një marreveshie për marrjen e automjeteve me qera nga kompanitë RENT MARA dhe RENT ELRONT. Në marrëveshjen ne mes të JAGUAR SECURITY SH.P.K dhe dy Kompanive për dhënie me qera të automjeteve ceket se JAGUAR SECURITY SH.P.K mund ti shfrytëzoj automjetet për nevojat e saj por nuk ceket se mund ti jap ne shfrytëzim kompanive tjera si ne rastin ne fjalë. Njëherit JAGUAR SECURITY SH.P.K nuk është pjese e grupit të konzorsiumit me ju."

OE ankuesi në ankesë pretendon se AK nuk ka vlerësuar ofertat konform neneve 1, 7,28,59,61,59 të LPP-së si dhe konform neneve 17, 27,40 të rregullores për prokurim publik nr 001/2022, nuk ka zbatuar në përpikmeri vendimin e PSH 593-597-594/23 të datës 16.11.2023 duke mos bërë vlerësimin e ofertave në bazë të nenit 59 dhe 72 të LPP-së.

Pretendimet e OE ankues kundër eliminimit të tyre nga AK:"Eliminimi i kompanisë sonë tendencioz dhe i gabuar: Edhe në vendimin paraprak të OSHP-së me nr.597-23 të datës 16.11.2023, Paneli Shqyrtues edhe në bazë të ekspertizës së kryer ka dhënë mbështetje në pa rregulluesin e AK-së kur ka bërë eliminimin e kompanisë sonë në lidhje me arsyetimin se nuk e përmbushim kërkesën me nr.3 lidhur me veturat patrulluese, edhe pse ne kemi dhënë dëshmi të mjaftueshme dhe kemi bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme.

Paneli Shqyrtues në vendimin e lëshuar e obligon AK-në që gjatë Rivlerësimit të ofertave të veproj në harmoni me Nenin 72 të LPP-së dhe duhet të veproj në bazë të konstatimeve të tyre, gjë që gjatë këtij procesi AK-ja nuk ka kërkuar asnjë sqarim në lidhje me ofertën tonë përkatësisht në lidhje me veturat patrulluese gjë që arsyetimi i tyre për eliminim nuk është i bazuar sepse marrëveshjet e lidhura me kompanitë që veturat mund ti shfrytëzojmë edhe ne si kompani për këtë aktivitet të prokurimit dhe se askund nuk ceket se një gjë e tillë nuk mund të ndodh, mirëpo e kundërta e arsyes së eliminimit gjendet në marrëveshjet e dorëzuara ku një gjë e tillë nga lejohet nga kompania me të cilën kemi marrëveshje."

Ekspertja Shqyrtuese pas shqyrtimit të shkresave të lëndës qartëson se, duke analizuar në E-prokurim, AK gjatë procesit të rivlerësimit nuk ka kërkuar sqarim nga OE ankues lidhur me veturat, i cili pretendim ka qenë i parashtruar edhe në lëndën me nr. 597/23, ku AK në vlerësimin e parë ka eliminuar të njëjtin me arsyetimin se i posedon vetëm dy vetura të dëshmuara me dokumente për shfrytëzim kurse për të tjerat mungon dokumentacioni që anëtaret e konzorciumit kanë në shfrytëzim.

Për të cilin pretendim në ekspertizën e parë 597/23 dhe vendimi PSH 593-597-597/23, kemi rekomanduar që në rivlerësim të sqarohen konform nenit 72 të LPP-së.

Kurse pas rivlerësimit, me vendimin B58 të datës 07.12.2023, OE ankuesi është eliminuar me arsyetimin se: Arsyetim: "Tenderi juaj është refuzuar për këtë arsyeje: "keni prezantuar automjetet të cilat nuk janë ne pronësinë tuaj Automjetet janë në pronësi të kompanive RENT MARA dhe RENT ELRONI me cilat ju nuk keni marrëveshje direkte për marrjen me qera të automjeteve. Ju ne oferte keni prezantuat një marrëveshje me kompaninë JAGUAR SECURITY SH.P.K e cila pastaj ka një marrëveshje për marren e automjeteve me qera nga kompanitë RENT MARA dhe RENT ELRONI. Në marrëveshjen ne mes të JAGUAR SECURITY SH.P,K dhe dy kompanive për dhënie me qera të automjeteve ceket se JAGUAR SECURITY SH.P.K mund ti shfrytëzoj automjetet për nevojat e saj por nuk ceket se mund ti jap ne shfrytëzim kompanive tjera si ne rastin në fjalë. Njeherit JAGUAR SECURITY SH.P.K nuk është pjesë e grupit të konzorciumit me ju."

Tutje, si e tillë gjatë procesit të rivlerësimit, AK nuk ka sqaruar të njëjtat: Kërkesa në DT:Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.2: Pika 3 .Pajisjet - Veturat patrulluese

3. Dëshmi qe tenderuesi posedon jo me pak se 4 (katër) vetura patrulluese te terrenit (4x4) . Te dëshmohet me kopje te certifikatave te regjistrimit te automjeteve (lejeve të qarkullimit). ku në vendim është sqaruar se në rivlerësim të kërkoni sqarime konform nenit 72 të LPP-së, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar, për faktin se AK nuk ka kërkuar sqarime.

"Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit te plote te gjendjes faktike, duke u mbështetur ne LPP si ligji material te zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marre parasysh të gjitha shkresat e lendës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se njoftimi i AK-se për dhënie të kontratës duhet të anulohet dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore ne këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet serish ne ri-vlerësim. Paneli i vlerëson dhe e mbështet arsyetimin e ekspertit shqyrtues sipas vlerësimit të pavarur të tij vlerëson se pretendimet e OE-ve ankues "Defence Security" "Security Code" dhe "S.I.G" për mos plotësim të kërkesës se dosjes së tenderit nga OE i rekomanduar është i bazuar për faktin se OE i rekomanduar ka bashkangjitur analizën financiare, ku shihet se ka kalkuluar shujtën e punëtorëve me çmimin 1.13 euro, gjersa AK ne DT ka kërkuar që shujta mos të jetë me e ulet se 2 euro. AK lidhur me këtë pikë ankimore nuk ka jap asnjë arsyetim ne përgjigjet e kërkesave për ri-shqyrtim. Kjo pikë e dosjes së tenderit, me saktësisht mos plotësimi i saj e bën të papërgjegjshëm OE të rekomanduar nga AK për dhënie të kontratës. Rrjedhimisht, paneli shqyrtues ne vlerësimin e tij të pavarur konsideron se me rastin e vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit te ofertave AK ka veruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

Me tej, paneli shqyrtues i vlerëson si të bazuara konstatimet e ekspertit shqyrtues, lidhur me pretendimet e operatoreve ekonomik, dhe sqaron se AK duhet të veproje konform këtyre konstatimeve/rekomandimeve gjatë rivlerësimit, dhe të kërkojë sqarime shtesë konform nenit 72

të LPP-së, sipas këtyre konstatimeve."

Pretendimi i OE ankues kundër OE të rekomanduarit: "Në anën tjetër me datën 07.12.2023 Autoriteti Kontraktues publikon njoftimin mbi vendimin e AK-së ku si rezultat e rekomandon për dhënie të kontratës OE "Defence Security & International Security AAH" Sh.p.k, pas ri-vlerësimit të ofertave, e që edhe kjo kompani nuk është e përgjegjshme në bazë të kërkesave të cekura nga ana e Autoritetit Kontraktues në dosjen e tenderit, pasi që pa-përgjegjshmërinë e këtij OE e keni edhe të filtruar nga ana e Panelit Shqyrtues të OSHP-së sepse i njëjti çmimin për shujtën e punëtorëve.Konstatimi i pestë (V): Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën e OE "Defence Security" SHPK sqaron se, OE ankuesi në ankesë ka bashkangjitur një dëshmi lidhur me analizën mirëpo tek shujta mendoj se ka ndërhyrje nga 2 euro OE ankues (ju) keni vendosur 1 euro, kurse sa i përket kalkulimit, në analizë shihet tek pika 4. Për festa 7500 euro, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta sqaroj analizën edhe njëherë, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht e bazuar. Autoriteti Kontraktues nuk e ka përfillur këtë konstatim të PSH-së, pasi që gjatë Rivlerësimit nuk e ka bërë sqarimin e analizës së OE të rekomanduar për kontratë "Defence Security & International Security AAH".

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit të shkresave të lëndës në E-prokurim, duke i analizuar dhe krahasuar po ashtu me raportin e ekspertizës 597/23, sqarojmë se, pretendimi në ankesën 597/23

ka qenë:

Përgjigje ne pretendimin e pestë te OE ankues kundër "Defence Secutity& International Security AHH SHPK." Pretendimi i pestë: tek ky operator ekonomik gjatë kalkulimeve qe ika bere shihet se nuk jen konform dispozitave ligjore të Ligjit nr.03/L-212 të punës, për shkak se llogaritja e çmimit njësi për orë punë nuk është konform nenit 56 të po këtij pasi që parashihen pagesat shtesë si orët e punës gjatë natës, gjatë festave, gjatë kujdestarisë si dhe gjatë vikendeve, për të cilat ky OE ju është shmangur kalkulimit të saktë, me ç'rast ka arritur të lajthit Autoritetin Kontraktues që të mos arrij që gjatë vlerësimit të beje llogaritja të saktë.

Ku pastaj vije konstatimi (V): "Eksperti shqyrtues sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën e OE "Defence Security" SHPK sqaron se, OE ankuesi në ankesë ka bashkangjitur një dëshmi lidhur me analizën mirëpo tek shujta mendoj se ka ndërhyrje nga 2 euro OE ankues (ju) keni vendosur 1 euro, kurse sa i përket kalkulimit, në analizë shihet tek pika 4. Për festa 7500 euro, mirëpo AK gjatë procesit të rivlerësimit duhet ta sqaroj analizën edhe njëherë, dhe si e tillë pretendimi gjendet pjesërisht e bazuar.

Ky konstatim vije për faktin se ju në dëshmitë tek analiza financiare në ankesën e parë keni bashkangjitur një analizë financiare ku pjesa tek shujta është 1 euro, mirëpo në E-prokurim analiza financiare e Defence Security ka të vendosur shujtën 2 euro, andaj edhe e kam sqaruar që ju si OE ankues keni vendosur 1 euro (në dëshmi), kurse sa i përket rekomandimit lidhur me sqarimin e analizës, gjatë procesit të rivlerësimit AK nuk ka kërkuar sqarim konform vendimi PSH. Nr. 594-597-593/23 dt: 16.11.2023:

"Me tej, paneli shqyrtues i vlerëson si të bazuara konstatimet e ekspertit shqyrtues, lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik, dhe sqaron se AK duhet të veproj konform këtyre konstatimeve/rekomandimeve gjatë rivlerësimit, dhe të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 72 te LPP-së sipas këtyre konstatimeve."

Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues, konsideroj se AK duhet të sqarohet, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën financiar, AK duhet të respektoj vendimin e PSH 594-597-593/23, duke sqaruar të gjitha deklaratat e potencuara nga OE i rekomanduar. Andaj si e tillë rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.I.G." SH.P.K., Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.I.G." SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit, në këtë mënyrë është gjetur se për aktivitetin e prokurimit me "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1 Për të cilin ka pasur vendim të nxjerrur nga PSH Nr. 593-597-597/23, ku është obliguar AK që të kërkoj sqarime shtesë konform nenit 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e "Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut" me nr. të prokurimit: KEK-23-4552-2-1-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.I.G." SH.P.K., dhe se argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues e mbështet në plotni raportin e ekspertit shqyrtues. Në këtë mënyrë eksperti shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "S.I.G." SH.P.K., janë pjesërisht të bazuara dhe janë të trajtuara me vendimin paraprak të OSHP për të cilat AK nuk e ka zbatuar në plotni, kur dihet mirë se vendimet e OSHP janë të zbatueshme deri sa ato nuk atakohen në ndonjë gjykatë sipas këshillës së dhënë juridike dhe nuk ka ndonjë vendim nga gjykata se vendimi duhet të pezullohet.

Eksperti shqyrtues thekson se pretendimet janë të njëjta dhe janë të trajtuara me vendimin PSH. Nr. 594-597-593/23 dt: 16.11.2023. Si përfundim, sipas sqarimeve më lartë, sa i përket arsyes së eliminimit të OE ankues, konsideroj se AK duhet të sqarohet, kurse sa i përket pretendimit të OE ankues lidhur me analizën financiar të OE të rekomanduar për kontratë, AK duhet të respektoj vendimin e PSH 594-597-593/23, duke sqaruar të gjitha deklaratat e potencuara nga OE i rekomanduar. Andaj si e tillë rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues mjaftë në detaje e ka elaboruar edhe herën e parë por edhe tani dhe e mbështet arsyeshmërinë e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim dhe të respektohen vendimet paraprake për këtë aktivitet të prokurimit dhe të kërkohen sqarime konform nenin 59 dhe 72 të LPP.

Përndryshme mos respektimi i vendimeve të OSHP dhe mos shterja e të gjitha mjeteve të cilat i ka AK mund ti shqyrtoj për një vlerësim të drejtë dhe të paanshëm, atëherë mund të nënkuptohet se AK me qëllim prolongon procedurën e prokurimit e cila më pastaj po rezultojnë edhe me lidhjen e kontratave përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**
- OE - **S.I.G. SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: